

**VEPRIMTARITË E NDËRMARRJEVE EKONOMIKE TË KOMUNËS SË
PEJËS NË VITET '70 DHE '80 TË SHEKULLIT XX NGA PRIZMI I
DOKUMENTACIONIT HISTORIK TË ARKIVIT NDËRKOMUNAL TË
PEJËS**

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË HISTORI E KOHËS SË RE

NGA

BRILANTINA NUSHI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

EKSPOZE E TEMËS

VEPRIMTARITË E NDËRMARRJEVE EKONOMIKE TË KOMUNËS SË PEJËS NË VITET '70 DHE '80 TË SHEKULLIT XX NGA PRIZMI I DOKUMENTACIONIT HISTORIK TË ARKIVIT NDËRKOMUNAL TË PEJËS

Mentori:

Prof. Dr. Gazmend Rizaj

Kandidatja:

Brilantina Nushi

Një prej elementeve më të rëndësishme për zhvillimin e çdo shoqërie konsiderohet ekonomia. Ekonomia është një element thelbësor që shtyn vendet drejt ndryshimit dhe hap mundësi të reja duke qenë një urë lidhëse në mes vendeve. Karakteristikë e shumë shteteve dhe vendeve është organizimi dhe lidhja e ekonomisë të tyre në baze të resurseve humane, kapitalit dhe atyre natyrore. Në këtë tezë do të analizojmë zhvillimin e ekonomisë në vitet e '70 dhe '80 të shekullit XX në qytetin e Pejës. Peja është qyteti i katërt më i madh i Kosovës, ndodhet në rajonin e Rugovës në pjesën lindore të Bjeshkëve të Nemuna përgjatë Lumëbardhit të Pejës në pjesën perëndimore të Kosovës. Peja ka rreth vetës shumë resurse natyrore të cilat i japin favore qytetit të Pejës për të zhvilluar ekonominë dhe të dominojë në shumë fusha për zhvillimin e saj. Ndër qendrat më të njohura dhe me më ndikim jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon është Peja, e cila njihet qysh prej shumë kohësh me klimë të përshtatshme, me pozitë gjeostrategjike, këto elemente janë parakushte për një zhvillim të hovshëm kulturor dhe ekonomik për qytetin e Pejës. Kryesisht në vitet 1971-1974 filloj faza e zhvillimit ekonomik të Pejës. Në vitin 1989 ekonomia e Pejës, më tërë infrastrukturën përcjellëse ishte ndër ekonomitë më të zhvilluara në krahasim me komunat e tjera të Kosovës, duke filluar me objektet industriale, hoteliere e turistike, industrinë e drurit, bujqësinë, ekonominë e vogël, artizanatet dhe zejjet e tjera. Në sajë të angazhimit të popullatës gjatë njëzet viteve (1970-1990), Peja bëhet faktor me rëndësi për zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror dhe ekonomik të Kosovës. Tregtia filloi të zhvillohej përmes ndërmarrjeve tregtare '17 Nëntori' të cilat posedonin 108 shitore dhe 9 depo. Furnizimi i konsumatorëve bëhej përmes 288 shitoreve të sektorit shoqëror në të cilat furnizoheshin 90 mijë banorë të kësaj komune. Edhe në Pejë sikur në pjesë të tjera të Kosovës hovin e madh ekonomik që e kishte përjetuar në vitet e '70, në vitet '80 shkoi duke u zbehur. Rrethanat politike pas demonstratave të pranverës së vitit 1981 patën impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik. Nga viti 1981 deri në vitin 1990 kishte një degradim ekonomik të ekonomisë pejane. Largimi izdhunshëm nga puna i mijëra punëtorëve rezultoi në krizë të madhe sociale në komunën e Pejës. Qeveria serbe përmes presionit largoi nga puna kuadrot shqiptarë duke menaxhuar vetëm me kuadro serbë.

Qëllimi

- Të paraqes numrin e veprimtarive ekonomike në Komunën e Pejës gjatë viteve të '80 duke i parë ato nga prizmi i ngjarjeve historike.
- Të analizojë llojin e veprimtarive më të suksesshme në vitet '80 të cilat sollën hov në zhvillimin ekonomik të Pejës.
- Të analizojë ndërmarrjet të cilët i mbijetuan viteve të degradimit ekonomik në Komunën e Pejës.
- Të paraqet një pasqyrë të kuadrove të të punësuarve dhe ndikimin që pati largimi i tyre i dhunshëm gjatë viteve '80.
- Të krahasojë zhvillimin ekonomik të Pejës në raport me komunat e tjera të Kosovës.

1. Organizimi i punimit

Në pjesën e parë paraqitet një përmbledhje e problemit, përshkrim i qëllimit dhe rëndësisë së punimit. Po ashtu bëhet paraqitja e shkurtër e metodologjisë së aplikuar dhe rezultateve të pritura të punimit.

Në kapitullin e parë paraqiten veprimtaritë ekonomike në Komunën e Pejës në vitet e 70-ta dhe 80-ta, duke përfshirë dhe një përshkrim të qytetit të Pejës dhe karakteristikat e veçanta që ishin shtysë për zhvillimin ekonomik.

Në kapitullin e dytë paraqiten zejet më fitimprurëse të cilat ishin karakteristike për qytetin e Pejës, duke bërë një paralelizmin në mes të zejeve që kanë ekzistuar dhe atyre që nuk i mbijetuan kohës. Gjithashtu do të analizohet dhe hoteleria që për Pejën ishte një aset shumë i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, ku rol kyç patën dhe hotelet e asaj kohe.

Në kapitullin e tretë analizohen kompanitë më me rëndësi dhe në gjendjen ekonomike të sotme të cilat u themeluan në vitet e 70-ta-80-ta. Disa prej këtyre kompanive sot konsiderohen motorët kyç në zhvillimin ekonomik për nga qarkullimet e tyre, e disa kompani të tjera kanë ruajtur të njëjtin asortiment prodhimi duke i mbijetuar kohës.

Në përfundim paraqiten konkludimet, rekomandimet, kufizimet e studimit dhe literatura e shfrytëzuarë.

